

Në bazë të nenit 55 alineja 1 i Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (" Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë") nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 i Ligjit për arsim fillor („ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë") nr. 6p. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 и 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1, alineja 4 i Ligjit për Byronë për zhvillimin e arsimit (" Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë") nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi Programin mësimorë për lëndën e shoqëris për klasën e II të arsimit fillorë për vitin shkollor 2020/2021



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BIRROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAM I SHKURTUAR ARSIMOR

SHOQËRI

Gusht 2020

KLASA E II

ARSIMI FILLOR
NËNTËVJEÇAR

1. Hyrje

Programi i shkurtuar për lëndën e Shoqëris bazohet në qëllimet /në rezultatet e pritura të parashikuara nga programi mësimor për lëndën që zbatohet rregullisht në përputhje me planin e përcaktuar mësimor.

Programi i shkurtuar përcakton tema të caktuara dhe njësi mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, ndërsa respektohet fondi javor i paraparë i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, 1 orë në javë, pra gjithsej 32 orë.

Mësimdhënësi në planifikimin dhe realizimin e njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet / rezultatet e pritura, termet e caktuara, metoda dhe aktivitete të përcaktuara në programet mësimore të rregullta.

2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

TEMA: UNË DHE TË TJERËT(5 ORË)
Njësit mësimore: <ul style="list-style-type: none">- Unë di, mundem, dua ;- Çka më pëlqen te vetja ;- Dallimet dhe ngjashmërit me njerzit;- Rregullat e klasës ;- Të drejtat dhe përgjegjësit.

TEMA: JETA DHE PUNA NË SHKOLLË (6 ORË)

Njësit mësimore:

- Hapësirat në shkollë ;
- Të punësuarit në shkollë ;
- Ne jemi të përgjegjshëm dhe të drejtë ;
- Si kujdesemi për mjetet shkollore;
- Festat.

TEMA: SHTËPIA IME (8 ORË)

Njësit mësimore:

- Anëtarët e familjes time;
- Familjarët e mi, llojet e familjeve;
- Hapësirat në shtëpi;
- Pajisje shtëpiake;
- Mbrojtja nga rreziqet dhe fatkeqësit natyrore;
- Higjiena personale dhe higjiena në shtëpi;
- Festat familjare;
- Koha e lirë.

TEMA: VENDI KU UNË JETOJ (7 ORË)

Njësit mësimore:

- Vendi ku unë jetoj;
- Lidhshmëria qytet dhe fshat;
- Mjedi më i afërt;
- Objektet në mjedisin më të afërt;

- Posta, ambulanca, stacioni policor;
- Ndërtesa të vjetra dhe të reja;
- Atdheu im.

TEMA: KOMUNIKACION (6 ORË)

Njësit mësimore:

- Lëvizja në rrugë;
- Siguria në vendin ku luajm;
- Shenjat e komunikacionit;
- Kalimi i sigurt dhe lëvizja në rrugë;
- Para udhëkryqit;
- Mjetet e komunikacionit.

3. Rekomandime didsktikore

Pika fillestare për realizimin e programit arsimor të shkurtuar në lëndën shoqëri është bazuar në programin e rregullt (qëllimet konkrete, konceptet, aktivitetet dhe metodat e propozuara). Realizimi efektiv i njësive mësimore në këtë program arsimor , veçanërisht për formimin e koncepteve nga nxënësit , mvaret shumë nga zbatimi i qasjes së integruar. Kjo do të thotë që kur planifikoni temën / orën ditore në shoqëri, mundësitë për lidhje të integruar me lëndët tjera përdoreni në maksimum: gjuhën amtare, matematikën, arsimin figurativ , arsimin muzikor dhe arsimin fizik dhe shëndetësor. Gjithashtu, mundet të përdoren dhe punëtori nga programi për aftësi jetësore. Duke pasur parasysh qëllimet mësimore, gjithmonë kur është e mundur, gjatë procesit mësimor nxënësve duhet tju mundësohen aktivitete të ndryshme dhe përmbajtje me interesat e tyre. Metodat më efektive për mësimin e lëndës shoqëri janë ata metoda ku nxënësit i vendosin në pozitë aktive në procesin e njohurive. Është e domozdoshme që mësuesi të formoj situata për mësimin ku do të dalin në sipërfaqe aktivitetet e ndryshme që mundësojnë realizimin e mësimin, përdorimin e mjeteve të ndryshme, materijale dhe burime për mësim.

3. Normativi për kuadrin mësimor

Programi i shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi sipas normativit për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar nga lënda Shoqëri të klasës së dytë të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratoi

Министер за образование и наука

Мила Царовска